

UDHËZIM
Nr.10, datë 27. 9.2003

**PËR RREGULLAT QË DUHEN RESPEKTUAR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Dodë Prenga	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 135 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Parim i përgjithshëm

Organet e qeverisjes vendore caktojnë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore.

Neni 2

Caktimi i vendeve të afishimit

1. Caktimi i këtyre vendeve duhet të realizohet duke përcaktuar sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabarta ndërmjet partive të pozitës dhe opozitës pjesëmarrëse në zgjedhje.

2. Për partitë parlamentare që në zgjedhjet e fundit kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në parlament, bashkia/ komuna, caktojnë dyfishin e sipërfaqes së afishimit të partive nën 20%.

3. Në caktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike, organet e qeverisjes vendore duhet të kenë parasysh:

- sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e qytetit;
- rrugët kryesore;
- vendet e veçanta;
- mundësinë e ndriçimit;
- kohën e barabartë në dispozicion.

Neni 3

Personat juridikë dhe fizikë

Për aq sa është e mundur, bashkitë/ komunat, kërkojnë zbatimin e rregullave të përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të këtij udhëzimi edhe nga personat juridikë dhe fizikë, që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në njësine administrative përkatëse.

Neni 4

Respektimi i barazisë

1. Rritja e hapësirave për afishimin e materialeve propagandistike, për njërin nga subjektet zgjedhore, rrit proporcionalisht hapësirën për subjektet e tjera.

2. Vënia në dispozicion e sipërfaqeve për afishimin e materialeve propagandistike bëhet me të njëjtin çmim për sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabartë.

Neni 5

Kompensimi

Në rastet kur KZQV-ja konstaton një ndarje të pabarabartë në kohë ose hapësirë midis subjekteve zgjedhorë të forcave ose blloqeve politikë të ndryshme, vendos kompensimin me sipërfaqe dhe kohë të afishimit në favor të subjekteve të dëmtuara, kompensim i cili duhet të realizohet brenda 24 orëve nga marrja e vendimit. Bashkia/komuna përkatëse detyrohet për zbatimin e vendimit të KZQV-së.

Neni 6

Sanksionet

Në rastet kur KQZ-ja konstaton kundërvajtje administrative, si dhe pasi ka marrë mendimin e KZQV-së përkatëse, vendos sanksione në përputhje me ligjin nr. 9087, datë 19. 06. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.